



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
AVOKATI I POPULLIT  
Seksioni i Administratës



Adresa: Bulevardi: "Zhan D'Ark" Nr.2  
Tiranë, Shqipëri

Tel/Fax: +355 4 2380 300/315  
E-mail: [ap@avokatipopullit.gov.al](mailto:ap@avokatipopullit.gov.al)  
[www.avokatipopullit.gov.al](http://www.avokatipopullit.gov.al)

Nr. Prot.  
Nr. Dok. 201502117/4

Tiranë \_\_\_/\_\_\_/2016

**Lënda :** *Marrjen e masave të menjëhershme për nxjerrjen e aktit për konstatimin absolutisht të pavlefshëm të Vendimit nr.72, datë 14.10.2015, si dhe lëshimin e dokumenteve të pronësisë ankueses L.S. për pasurinë e njohur në pronësi me të drejtë kthimi në natyrë, sipas Vendimit nr.103, datë 28.12.1993, të dhënë prej Komisionit të Kthimit dhe Kompesimit të Pronave Ish-pronarëve, Bashkia, Shkodër.*

**Drejtuar :** Regjistruarit të ZVRPP

**SHKODËR**

**Për dijeni :** Ministrisë së Drejtësisë

**Kryeregjistruarit të Zyrës Qendrore të Regjistrimit të pasurive të Paluajtshme**  
Z.Illirjan Muho

**L.S**  
Adresa:

**SHKODËR**

Z.Regjistruarit!

Institucioni i Avokatit të Popullit, ka pranuar për shqyrtim ankesën e shtetasës LS, në të cilën prezantohet shqetësimi për moslëshimin e akteve të pronësisë për pasurinë e regjistruar me nr.227 të regjistrimit hipotekor, datë 25.01.1994.

Referuar akteve të vëna në dispozicion prej ankueses, rezulton se, pasuria e regjistruar me nr.227 të regjistrimit hipotekor, datë 25.01.1994, është njohur në pronësi me të drejtë kthimi në natyrë trashgimtarëve ligjor të të ndjerit A.D.E, sipas Vendimit nr.103, datë 28.12.1993, të dhënë prej Komisionit të Kthimit dhe Kompesimit të Pronave Ish-pronarëve, Bashkia, Shkodër.

Kjo pronë sipas përcaktimit të kryer në Vendimin nr. 103, datë 28.12.1993, ka përmasat 5x7m<sup>2</sup> dhe ndodhet në Lagjen "Vasil Shanto", Rruga "8 Marsi", Shkodër, dhe

kufizohet në Veri, me I.E., Perëndim me Rruga “8 Marsi”, Lindje me I.E., Jugu me derën e hyrjes së shtëpisë. Me rastin e hedhjes në sistem të pasurive të ndodhura në zonën kadastrale ku dhe ndodhet pasuria e ankueses, është kërkuar(aplikuar) prej saj për marrjen e dokumenteve të pronësisë për pasurinë e njohur në pronësi me të drejtë kthimi në natyrë sipas Vendimit nr.103, datë 28.12.1993, të KKKP, Bashkia, Shkodër.

Përkundër kërkesë së ankueses për marrjen e dokumentacionit të pronësisë ju, z.Regjistruues, keni vendosur me Vendimin nr. 72, datë 14.10.2015, për refuzimin e regjistrimit të pasurisë me nr.227 të rregjistrimit hipotekor, datë 25.01.1994, në pronësi të ankueses. Referuar pjesës përshkuese të vendimit të dhënë nga ana juaj, konstatohet se, ju e trajtoni regjistrimin e pronës së ankueses, referuar nenit 25/b të ligjit nr.33/2012 “Për regjistrimin e pasurive të paluajtshme”, duke përmendur me këtë rast, se, keni administruar aktet e dorëzuara prej ankueses, si;

1)Vërtetim pronësie me nr.227, datë 25.01.1994 të lëshuar nga ZVRPP, Shkodër.

2)Vendim gjykate (vërtetim fakti) nr.2926, datë 25.01.1995(pa përcaktuar se cila gjykatë e ka dhënë dhe për çfarë sendi është vendosur).

3)Vërtetim datë 24.07.1993. (pa përcaktuar se cili organ e ka lëshuar dhe se për çfarë fakti flitet në të).

4)Planvendosje(pa përcaktuar se për cilën pasuri është përgatitur).

5)Vërtetim pronësie nr.54, datë 06.02.1928(pa përcaktuar se cili organ e ka lëshuar dhe për cilën pasuri flitet).

Për faktin e regjistrimit të pronës së ankueses me nr.227 të rregjistrimit hipotekor, datë 25.01.1994, ju, shpreheni në pjesën përshkuese të vendimit, se ; “Kjo pasuri nuk mund të verifikohet pasi nuk ka rregjistër pranë arshivës së ZVRPP, Shkodër”. Në këtë pohim të dhënë nga ana juaj kuptohet se bëhet fjalë për humbjen, zhdukjen e dokumentacionit,(rregjistrimit të pronave) situatë e cila kërkon kryerjen e veprimeve për nxjerrjen e përgjegjësive si nga Ju, Kryeregjistruuesi apo Ministria e Drejtësisë, e cila administron veprimtarinë e regjistrimit publik për pasuritë e paluajtshme, sikurse parashikuar në nenin 198 të Kodit Civil.

Në ndryshim nga pohimet e dhëna nga ana juaj në pjesën përshkuese të Vendimit nr.72, datë 14.10.2015, ankuesja, shprehet se, ka kërkuar dhe kërkon rregjistrimin e pasurisë së njohur në pronësi me të drejtë kthimi në natyrë sipas Vendimit nr.103, datë 28.12.1993, të KKKP, Bashkia, Shkodër. Në kushtet kur pasuria e njohur në pronësi, me të drejtë kthimi në natyrë, sipas Vendimit nr.103, datë 28.12.1993, të KKKP, Bashkia, Shkodër, figuron e rregjistruar me nr.227 të rregjistrimit hipotekor, datë 25.01.1994, fakt i cili është i pranuar nga ana juaj me rastin e lëshimit të Vërtetimit datë 25.10.1994, është e pa justifikueshme mospasqyrimi i saj me rastin e hedhjes në sistem të pasurive të zonës kadastrale ku dhe ndodhet pasuria e ankueses. Pra, në këtë situatë nuk mund të flitet për regjistrim fillestar të pasurisë. Titulli i Pronësisë, Vendimi nr. 103, datë 28.12.1993 dhe plani i rievimit i Vitit 1962 që bashkëlidhet këtij vendimi, janë të administruara dhe administrohen nga ana juaj, me rastin e regjistrimit të këtij titulli pronësie me numër 227 të rregjistrimit hipotekor, datë 25.01.1994.

Ankuesja ka kërkuar dhe kërkon lëshimin e dokumentave të pronësisë për pronën e njohur dhe kthyer në natyrë sipas Vendimit nr. 72, datë 14.10.2015, të KKKP, Bashkia, Shkodër, konform parashikimeve të kryera në Ligjin nr.33/2012, “Për rregjistrimin e

*pasurive të paluajtshme*”, neni 45, ligjin nr.7850, datë 29.07.1994, (Kodi Civil), neni 193.

Vendimi i marrë nga ana juaj “Për refuzimin e regjistrimit të pasurisë me nr.227 të rregjistrimit hipotekor, datë 25.01.1994”, në pronësi të ankueses, vjen në kundërshtim me parashikimin e kryer në nenin 20/dh të ligjit nr.33/2012 “Për regjistrimin e pasurive të paluajtshme”, në të cilin parashikohet se :

*“Regjistruesi ka Këto kompetenca;*

...

*dh) t’i propozojë Kryeregjistruesit refuzimin e regjistrimit kur nuk plotësohen kushtet e përcaktuara në këtë ligj”.*

Pra, akti i nxjerr nga ana juaj në kuptim dhe zbatim të parashikimit të nenit 116/b të K.Pr.Administrative, se:

*“Aktet administrative do të quhen absolutisht të pavlefshme, në kuptimin e këtij Kodi, në rastet e mëposhtme;*

*b) kur akti është nxjerrë nga një organ administrativ në kapërcim të kompetencave të tij”,*

konsiderohet, quhet absolutisht i pavlefshëm

Në kushtet kur akti administrativ, Vendimi nr. 72, datë 14.10.2015, i nxjerrë nga ana juaj, nuk prodhon asnjë pasojë ligjore, vlerësojmë të nevojshme e të domosdoshme, marrjen e masave nga ana juaj për nxjerrjen e aktit për konstatimin absolutisht të pavlefshme të Vendimit nr. 72, datë 14.10.2015.

Vendimmarrja juaj nr.72, datë 14.10.2015, ka cënuar dhe cënon marrëdhëniet juridike të vendosura me ligj për ekzekutimin e titujve ekzekutiv, të cilat sigurojnë jo vetëm veprimtarinë e rregullt të organit që ju përfaqësoni, por dhe mbrojtjen e interesave të ligjshme të shtetasve apo të shtetit, të mbrojtura posaçërisht nga legjislacioni penal kundër veprimeve ose mosveprimeve kriminale.

Funksionimi i organit që ju përfaqësoni në dhënien e shërbimit të kërkuar prej ankueses L.S., nuk vjen në respektim të parimit të ligjshmërisë, parimit të mbrojtjes së interesit publik dhe të të drejtave të personave private, të parashikuara në nenin 9 dhe 10 të Kodit të Procedurës Administrative dhe detyrueshme në kuptim dhe zbatim të nenit 1 të këtij Kodi.

Qëndrimin e derisotëm të mbajtur nga ana juaj e vlerësojmë në cënim të së drejtës së pronësisë, parimit për zhvillimin e një procesi të rregullt ligjor, sikurse sanksionuar respektivisht në nenin 41, 42 të Kushtetutës, neni 6/1 të Konvetës Europiane e të Drejtave të Njeriut (miratuar me ligjin nr.8137, datë 31.07.1996), neni 1 të Protokollit nr.1 të Konvetës, si rrjedhojë e nxjerrjes së mosmarrjes së masave në afatin e vendosur për lëshimin e dokumenteve të pronësisë në favor të subjektit ankues.

Në situatën juridike në të cilën ndodhet çështja, Avokati i Popullit, nisur nga parimi i zbatimit të ligjshmërisë, rritjes së efektivitetit në ekzekutimin e vendimeve gjyqësore të formës së prerë, si dhe për një zgjidhje ligjore të këtij problemi çmon me vend të bëjë këtë rekomandim, duke shpresur se kështu do të ndihmojmë bashkërisht për vënien në vend të së drejtës të shkelur ankueses në fjalë.

Për të gjitha këto arsye, në përputhje me nenin 63/3 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë në të cilin thuhet se : *“Avokati i Popullit ka të drejtë të bëjë rekomandime*

*dhe të propozoje masa kur konstaton shkelje të të drejtave dhe lirive nga Administrata publike”, si dhe nenin 21/b të ligjit nr.8454, datë 04.02.1999 “Për Avokatin e Popullit”, të ndryshuar, i cili parashikon se : “Avokati i Popullit paraqet rekomandime për marrje masash për vënien në vend të së drejtës së shkelur tek organi administrativ që ka shkaktuar shkeljen”,*

## **REKOMANDOJMË**

*Marrjen e masave të menjëhershme për nxjerrjen e aktit për konstatimin absolutisht të pavlefshëm të Vendimit nr.72, datë 14.10.2015. si dhe lëshimin e dokumenteve të pronësisë ankueses L.S. për pasurinë e njohur në pronësi me të drejtë kthimi në natyrë, sipas Vendimit nr.103, datë 28.12.1993, të dhënë prej Komisionit të Kthimit dhe Kompesimit të Pronave Ish-pronarëve, Bashkia, Shkodër.*

Lidhur me shqyrtimin që do të kryhet rekomandimit të dhënë, konform nenit 19 të ligjit nr.8454, datë 04.02.1999 “Për Avokatin e Popullit”, të ndryshuar, kthimi i përgjigjes duhet të bëhet brenda 30 ditëve nga data e dërgimit të kësaj shkrese.

*Bashkëlidhur ju dërgojmë:*

*Kopje të Vendimit nr.103, datë 28.12.1993, të dhënë prej Komisionit të Kthimit dhe Kompesimit të Pronave Ish-pronarëve, Bashkia, Shkodër, së bashku me plan rilevimit bashkëngjitur.*

*Kopje të Vendimit nr.72, datë 14.10.2015 të Regjistruarit të ZVRPP, Shkodër.*

*Vërtetim nr.7769 prot, datë 13.10.2015, të ZVRPP, Shkodër.*

**KOMISIONERE**

**Etilda GJONAJ(SALIU)**

**Konceptoi dhe Daktilografoi  
A.Gjoleka**